



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 80 prot.

Kamëz, më 18. 6. 2021

V E N D I M

Nr. 66 .Datë 18/ 6 2021

MBI

Një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.118.datë 06.10.2020 "Miratimin e familjeveqëpërfitojnëngaprogrami social "Subvencionimi i interesave të kredisë", për vitin 2020 me fondet e buxhetit të shtetit".

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 18.06.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt – Nr.57 Datë 16.06.2021** në mbështetje të nenit 8 , pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja“b”nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat2dhe 6, tëligjit nr. 139/2015, "Për vete qeverisjen vendore", ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", Vendimit nr.66, datë 25.06.2020, të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit "Subvencionimi i interesave të Kredisë"i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, vendirnit nr. 60, datë 23.12.2019, të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2020,2021,2022", të vendimit nr. 384, date 12.06.2019, të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore, vendimit nr. 453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti",si dhe në vijim të raportit përmbledhës të Komisionit të Strehimit, si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, **Këshilli Bashkiak Kamëz**";

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së familjeve që përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë", familje të cilat zëvendësojnë kuotat e mbetura bosh nga lista e përfituesve të vitit 2020,si rrjedhojë e tërheqjes së tyre nga kjo listë, sipas Aneksit nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtijvendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- Familjet e përcaktuara në Aneksin nr.1 paraqiten pranë institucioneve bankare brenda 6 muajve nga momenti i njoftimit që kryen Bashkia Kamëz. Mos repektimi i këtij afati është shkak për skualifikimin e tyre.
- Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave Civile & Strehimitsidhe Drejtoria e Financës & Kontabilitetit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projekt-vendimi.

Bashkëngjitur këtij projekt-vendimi gjendet lista e familjeve përfituese si dhe lista e familjeve që janë tërhequr nga lista fituese sipas Vendimit nr.118 datë 06.10.20:

2. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Nën/ Kryetar Këshilli

